

V E N D I M
Nr. 333, datë 15.7.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 197, DATË 18.3.1996 “PËR RRJETIN E INSTITUCIONEVE
SHKENCORE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”, në lidhjen I, Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve Mekanike (ISPM) dhe Byroja e Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Drurit (BSPID) shkrihen në një person juridik të vetëm.
 2. Krijohet Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve të Mekanikës dhe të Drurit (ISPMD), me qendër në Tiranë, i cili do të varet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
 3. Veprimtaria kërkimore, shkencore, objekti, mjetet kryesore, baza materiale dhe arkivi i Institutit të Studimeve dhe të Projektimeve Mekanike dhe Byroja e Studimeve dhe e Projektimeve të Industrisë së Drurit i kalojnë Institutit të Studimeve dhe Projektimeve Mekanike dhe të Drurit.
 4. Selia e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve Mekanike të jetë në mjediset ku ndodhet Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Mekanike të Drurit, pranë Institutit të Teknologjisë Minerare.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko